



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 69/2 prot

Datë 12.01.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI ORËN E HAPJES SË OFERTAVE

Objekt: Anulimi i procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-90947-12-14-2023, me objekt “*Furnizim vendosje e sistemit te monitorimit te parkimit*”, me fond limit 5 640 868 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NUIS L01606034A, me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Berat me adresë: Rruga Antipatrea, Berat

Në datën 11.01.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 69/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3746 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-90947-12-14-2023, me objekt “*Furnizim vendosje e sistemit te monitorimit te parkimit*”, me fond limit 5 640 868 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me orën e hapjes së ofertave.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë pretendimet që operatori ekonomik “PC STORE” SHPK ka parashtruar në ankesën me nr. 69 prot., datë 11.01.2024.

Konkretisht në ankesë pretendohet se autoriteti kontraktor Bashkia Berat, e ka mbyllur në SPE procedurën dhe ka kryer hapjen e ofertave, para orarit të caktuar në dokumentat e tenderit, ndaj dhe kërkohet anulimi i saj [...].

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 12.01.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro